

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6788
E enjte, 22 dhjetor 2022
çmimi 0.40 €

Shqipëria blen "Bajraktarë" nga Turqia

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KFOR-i THOTË SE ËSHTË I GATSHËM TA PENGOJË DHUNËN NË VERI

FAQE 4-5



KFOR-i thotë se beson fuqishëm se përdorimi i dhunës dhe sjellja agresive në veri, për të ndikuar në vendimet politike në Kosovë, është i papranueshëm dhe perceptohet si provokim, duke shtuar se është përgjegjësi e të gjithëve që ta garantojnë sigurinë kolektive të rajonit. "KFOR-i mbetet vigilent dhe i gatshëm për të reaguar. Nëse është e nevojshme, ne jemi të përgatitur të ndërhyjmë, por ne parandalojmë përshkallëzimin në përputhje me mandatin tonë të OKB-së", thuhet në njoftimin e KFOR-it

AKTUALE



**OKSS-JA: FSK-JA, INSTITUCIONI
MË I BESUESHËM NGA QYTETARËT**

F. 5

**PSD-ja KËRKON AMENDAMENTIMIN
E LIGJIT PËR GJYKATËN SPECIALE**

F. 6

**HOTI: NJOHJA NGA IZRAELI
KA HAPUR DYERT E REJA
TË BASHKËPUNIMIT NË MES
TË KOSOVËS DHE IZRAELIT**

F. 7

EKONOMI



**SI U SHNDËRRUA BREZOVICA NË
SKEMË KORRUPSIONI**

F. 8

DOSSIER

**BISEDË ME HYSEN TËRPEZËN
TË GJITHË E DININ QË UNË ME SERBË
NUK PUNOJ (II)**

F. 9-11

SPORT



**LAURA FAZLIU, E ARGJENDTË NË
JERUSALEM**

F. 12

**KRASNIQI:
MARRËVESHJA
KOSOVË - SERBI
PA NJOHJE TË
NDËRSJELLË
MUND TË ÇOJË NË
STATUS QUO TË RE**

FAQE 3



**FILLON 'KARVANI I
VAKSINIMIT' NË KOSOVË**

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shqipëria blen “Bajraktarë” nga Turqia

TI RANË, 21 DHJETOR - Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje për blerjen e një flote të avionëve ushtarakë pa pilot nga kompania turke “Bayraktar”.

Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Niko Peleshi, tha se kjo ndihmë që vjen nga qeveria turke ka rëndësi të madhe për sigurinë kombëtare, por edhe atë të aleancës së NATO-s.

Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe kompanisë turke “Bayraktar”, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, tha se kjo marrëveshje është arritur falë partneritetit strategjik me Turqinë dhe për këtë falënderoi presidentin turk Rexhep Tajip Erdogan.

Rama bëri të qartë se dronët do të përdoren edhe për misionet ushtarake, por edhe policore dhe civile. “Tre dronët që do të vijnë të parët do të jenë plotësisht të armatosur dhe të gatshëm për çdo rast dhe shpresoj që të mos ndodhë kurrë, por nuk jetojmë në kohë të sigurta. Kur siguria jonë kombëtare të jetë në kërcënim, do të jemi gati për luftë”, tha Rama.

Si Rama ashtu edhe Peleshi thanë se dronët do të ndihmojnë edhe për ta monitoruar trafikun, por edhe territorin sa i përket kultivimit të kanabisit, zjarreve apo ndërtimeve pa leje si dhe për t’i ndjekur personat e kërkuar.

Rama bëri me dije se marrëveshja nuk është vetëm për t’i blerë dronët, por përfshin edhe mirëmbajtjen e tyre, trajnimin e më shumë se 30 personave, që do të përzgjidhen me ndihmën e kompanisë “Bayraktar” për t’u përgatitur për të marrë funksionin e qendrës së kontrollit, që do të jetë objekt i teknologjisë më të lartë në bazën ajrore të Kuçovës.

Në shtator të këtij viti Rama pati deklaruar se Shqipëria do të marrë gjashtë dronë të armatosur “Bayraktar” nga Turqia, ndërsa sot deklaroi se fillimisht do të vijnë tre dronët e parë, por nuk u deklarua shifër tjetër për në vijim. Nuk dihet sa i ka kushtuar Shqipërisë një dron, por në shtator Rama pati folur për “çmim të leverdishëm”, pa dhënë shifër konkrete.

Interesim për dronët turq “Bayraktar” kanë shprehur edhe

shtetet e tjera, pasi ky mjet ka treguar sukses në disa fushëbeteja, përfshirë Ukrainën dhe Azerbajxhanin.

Të paktën 36 dronë të llojit TB2 janë blerë nga forcat e armatosura ukrainase.

Droni TB2 është zhvilluar në Turqi nga Selcuk Bayraktar, i diplomuar në Institutin e Teknologjisë të Masaçusetsit. Ai krahasohet me amerikanin Elon Musk për avionin unik ushtarak që ka zhvilluar dhe për një prani në rrjetet sociale, ku shpesh është i egër ndaj kritikëve të tij.

Bayraktar, i cili është shef i teknologjisë në kompaninë e mbrojtjes “Bayraktar”, më 2016 është martuar me vajzën e presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ku ka qenë dëshmitar kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.

“Bayraktar TB2” mund të qëndrojë në qiell deri në 27 orë dhe kjo mundësohet nga një motor i thjeshtë me helikë dhe, po ashtu, mund të fluturojë deri në 150 kilometra nga baza e tij. Kjo fluturake, po ashtu, mund të pajisjet me katër raketa të llojit të “mikro municioneve të



mençura”, që janë mjaft të sakta për të shkatërruar automjete të blinduara nga disa kilometra distancë.

Dronët TB2 janë përdorur nga Turqia në ato që ajo i quan operacione “kundër terrorizmit” kundër militantëve kurdë, por edhe në luftën civile që ende po vazhdon në Libi. Por, ndikimi i tyre shkatërrues u pa gjatë konfliktit të vitit 2020 mbi rajonin e kontestuar të Nagorno Karabakut, kur dronët TB2 u

përdorën nga Azerbajxhani kundër forcave etnike armene. Por, ky dron shihet si revolucionar për shkak të kostos realitivist të lirë dhe disponueshmërisë së lehtë. Dronët e mëdhenj ushtarakë të prodhuar nga Shtetet e Bashkuara, sikurse MQ-9 Reaper, kushtojnë dhjetëra-miliona dollarë, madje shtetet që mund të përballojnë një teknologji të tillë ka pak gjasa që mund t’i blejnë këto fluturake.

ShBA-ja planifikon 45 miliardë dollarë ndihmë për Ukrainën



WASHINGTON, 21 DHJETOR - Ligjvënësit amerikanë prezantuan më 20 dhjetor një projektligj, ku në paketën e shpenzimeve prej 1.7 trilionë dollarësh, përfshihen rreth 45 miliardë dollarë ndihmë urgjente për Ukrainën. Nëse projektligji miratohet, kjo do të ishte ndihma më e madhe amerikane për ukrainasit. Votimi pritet të bëhet para mesnatës së 23 dhjetorit, sipas kohës lokale.

Presidenti amerikan, Joe Biden, i kishte kërkuar Kongresit në nëntor, që të sigurojë më shumë se 37 miliardë dollarë ndihmë

urgjente për këtë shtet.

Dhjetori është koha kur Kongresi amerikan ndan buxhetin për vitin pasues, dhe nëse kërkesa për ndihmë aprovohet, ajo do të jetë pjesë e paketës për mbështetjen e qeverisë ukrainase deri në shtatorin e vitit 2023.

Në fillim të nëntorit ShBA-ja tha se do të dërgojë në Ukrainë ndihmë të re ushtarake në vlerë prej 400 milionë dollarësh. Pothuajse dyfishi i kësaj shume, 725 milionë dollarë, ishte ndihma që iu dha Ukrainës nga ShBA-ja në fillim të tetorit. Në po këtë muaj NATO njoftoi se do

të dërgojë sisteme të reja të mbrojtjes ajrore dhe ndihmë tjetër ushtarake për Ukrainën në mënyrë që Kiev të mbrohet nga sulmet ajrore ruse që po godasin të gjithë vendin. Në Ukrainë luftimet e ashpra po vazhdojnë në Donjeck, teksa forcat ruse vazhduan sulmet e tyre në lindje.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, do të qëndrojë në Uashington të mërkurën për t’u takuar me presidentin Joe Biden.

Ky është udhëtimi i tij i parë jashtë vendit që kur nisi nga pushtimi rus në shkurt. Pushtimi

Irani propozon dënime më të ashpra kundër atyre që publikojnë “lajme të rreme”

TEHERAN, 21 DHJETOR - Ligjvënësit iranianë të linjës së ashpër kanë propozuar një plan për të vendosur dënime më të ashpra ndaj atyre që publikojnë lajme që mendohet se kanë “pasojë negative sociale”. Sipas planit, ata që publikojnë në media “lajme të rreme” apo “fake news” do të jenë përgjegjës për pasojat negative sociale që rrjedhin prej tyre. Rregullat do të “zbatohen për çdo lloj lajmi”. Mohammad Taghi Naqдали,

një anëtar i komisionit ligjor të Parlamentit iranian, tha se ndjekja penale dhe ndëshkimi nuk kufizohen vetëm për ata që publikojnë lajme me pasojë negative, por “dënimi është përcaktuar edhe për individët ose mediet që ekzagjerojnë lajmin”.

Agjencia e lajmeve “Tasnim”, e cila është e lidhur me Korpusin e Gardës Revolucionare Islamike (IRGC), e quajti planin kundërmasë ndaj protestave mbarëkombëtare në Iran, me

synimin për të fituar më shumë kontroll mbi përdoruesit e medieve sociale.

Më 8 dhjetor Irani kreu ekzekutimin e parë që lidhet me protestat kundërqeveritare. Mijëra iranianë kanë protestuar në mbarë vendin qëkur Mahsa Amini vdiq në paraburgim. Ajo po akuzohej nga autoritetet se kishte shkelur rregullat e veshjes së hijshimit, apo shamisë së kokës.



Fillon 'Karvani i vaksinimit' në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se sot (e enjte) në Kosovë do të nisë një aktivitet shtesë me qëllim të promovimit të vaksinimit kundër gripit sezonal dhe kundër Covid-19, i quajtur "Karvani i vaksinimit". "Ky është një aktivitet shtesë njëmuajor me qëllim të promovimit të vaksinimit kundër gripit sezonal dhe kundër Covid-19 dhe rritjes së numrit të të vaksinuarve kundër këtyre dy sëmundjeve. Tashmë qytetarët e Kosovës mund ta vaksinohen kundër Covid-19 edhe me dozat bivalente përforcuese", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë, duke bërë me dije se "Karvani i vaksinimit" do të nisë me komunën e Fushë-Kosovës.

Sipas MSh-së, ky aktivitet synon që t'i ndihmojë qytetarët për ta kuptuar sa më mirë rëndësinë e vaksinimit, njëkohësisht për t'u vaksinuar kundër gripit sezonal dhe kundër Covid-19, në kohën kur në vende të ndryshme të botës numri i rasteve të reja të Covid-19 ka filluar të rritet. "Për këtë qëllim, për një periudhë kohore prej më shumë se një muaji, në komunat e Kosovës ekipet e vaksinimit do t'u mundësojnë qytetarëve që të vaksinohen përmes këtij

aktiviteti", ka njoftuar MSh-ja.

Objektivat e "Karvanit të vaksinimit" janë: Inkurajimi i qytetarëve për vaksinim kundër Covid-19 dhe kundër gripit sezonal dhe promovimi i sjelljeve parandaluese dhe masave të shëndetit publik; Sigurimi që vaksinimi kundër gripit sezonal dhe Covid-19 të jetë lehtësisht i arritshëm në komunitetet lokale, veçanërisht për popullatën me të ndjeshme dhe; Promovimi i pjesëmarrjes së drejtuesve të komunitetit në aktivitetet lokale për t'i adresuar pengesat në procesin e vaksinimit.

Gjatë "Karvanit të vaksinimit", përveç vaksinës kundër gripit sezonal, qytetarët do të mund të vaksinohen edhe me dozat bivalente përforcuese kundër Covid-19, të siguruar nga Ministria e Shëndetësisë. "Dozat bivalente përforcuese kundër Covid-19 janë në dispozicion të qytetarëve në të gjitha qendrat e vaksinimit në komunat e Kosovës. Këto vakcina mbrojnë si nga virusi fillestar që shkakton Covid-19, po ashtu edhe nga varianti Omicron. Gjithashtu, ndihmojnë në rivendosjen e mbrojtjes që është zbehur me kalimin e kohës dhe ofrojnë mbrojtje më të gjerë kundër varianteve më të reja të virusit. Për ta vazhduar mbrojtjen kundër



Covid-19, sigurohuni ta merrni dozën bivalente përforcuese, të tretë ose të katërt!", ka njoftuar kjo ministri.

Kjo nismë është organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike me mbështetjen e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Kush mund të vaksinohet me dozën bivalente përforcuese? "Vaksina bivalente 'Pfizer' është e autorizuar si një dozë e vetme përforcuese për individët 12 vjeç e

lart. Edhe pse vakcina bivalente kundër Covid-19 me variantet 'Omicron' është aprovuar për përdorim te personat e moshës 12 vjeç e lart, si një dozë e vetme përforcuese. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike këshillon që me doza përforcuese bivalente të vaksinohen me prioritet personat mbi 60 vjeç, punëtorët shëndetësorë, ata me imunitet të komprometuar (nga moshë 12 vjeç) dhe gratë shtatzëna. Vaksina bivalente përforcuese kundër Covid-19 mund të bashkad-

ministrohet me vakcina të tjera, duke përfshirë vaksinën kundër gripit", është bërë me dije në njoftimin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Kur mund ta marrin qytetarët dozën bivalente përforcuese? "Doza bivalente përforcuese mund të merret kur kanë kaluar së paku dy muaj nga doza e dytë ose e tretë kundër Covid-19. Doza bivalente përforcuese mund të merret vetëm si dozë përforcuese - e tretë ose e katërt, e jo si dozë e parë ose e dytë", ka njoftuar MSh-ja.

Krasniqi: Marrëveshja Kosovë - Serbi pa njohje të ndërsjellë mund të çojë në status quo të re



PRISHTINË, 21 DHJETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë arritja e marrëveshjes me Serbinë do të duhej të rezultonte me njohjen e ndërsjellë. Në një intervistë për "Zërin e Amerikës", ai ka thënë se propozimi evropian i mbështetur nga Shtetet e Bashkuara për një marrëveshje pa njohje nuk mund të jetë i pranueshëm sepse do të mund të krijonte një status-quo të re.

Krasniqi ka thënë se bllokadat aktuale në veriun e Kosovë janë vendosur, para së gjithash, për ta penguar procesin e bisedimeve Kosovë - Serbi për një marrëveshje përfundimtare. "Situata në pjesën veriore të Kosovës është jashtëzakonisht problematike, ka një përkeqësim të gjendjes, sidomos pas vendosjes së barrikadave nga grupet kriminale, të cilat janë të kontrolluara dhe orkestruara drejtpërdrejt nga

qarqet më të larta në Serbi, duke përfshirë edhe vetë presidentin (Aleksandër) Vuçiq. Ka një tensionim të situatës dhe nga të gjitha informacionet që marrim këto ditë, shihet se nuk ka një zgjidhje të lehtë dhe nuk duket se mund të ketë një përmirësim dhe një kthim në normalitet shumë shpejt. Kjo është shumë shqetësuese", ka thënë Krasniqi. Ai ka thënë se PDK-ja ka kërkuar që kryeministri Kurti të jetë serioz në qasjen e tij në raport

me partnerët ndërkombëtarë dhe në pjesëmarrjen në dialog. Duke folur për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, Krasniqi ka thënë se duhet të jetë pjesë e marrëveshjes së përgjithshme e cila rezulton me njohjen e ndërsjellë. "Asociacioni, edhe kur është diskutuar për të, asnjëherë nuk është diskutuar që të ketë kompetenca ekzekutive, asnjëherë nuk është diskutuar dhe as kërkuar që të ketë çfarëdo

lloj karakteri që del jashtë Kushtetutës së Kosovës. Asociacioni, nëse themelohet, ai duhet të jetë pjesë e marrëveshjes së përgjithshme që rezulton me njohje të ndërsjellë. Duhet të jetë një grumbullim i kompetencave ekzistuese brenda Kushtetutës së Kosovës, të cilat mund të modelohen për t'u dhënë një siguri që e kërkon komuniteti serb në Kosovë", ka thënë lideri i PDK-së, Memli Krasniqi.



KFOR-i thotë se është i gatshëm ta pengojë dhunën në veri

KFOR-i thotë se beson fuqishëm se përdorimi i dhunës dhe sjellja agresive në veri për të ndikuar në vendimet politike në Kosovë është i papranueshëm dhe perceptohet si provokim, duke shtuar se është përgjegjësi e të gjithëve që të garantojnë sigurinë kolektive të rajonit. “KFOR-i mbetet vigjilent dhe i gatshëm për të reaguar. Ne jemi të përgatitur të ndërhyjmë, nëse është e nevojshme, por ne parandalojmë përshkallëzimin në përputhje me mandatin tonë të OKB-së”, thuhet në njoftimin e KFOR-it

EPOKA ERE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 21 DHJETOR - KFOR-i thotë se beson fuqishëm se përdorimi i dhunës dhe sjellja agresive në veri për të ndikuar në vendimet politike në Kosovë është i papranueshëm dhe perceptohet si provokim, duke shtuar se është përgjegjësi e të gjithëve që ta garantojnë sigurinë kolektive të rajonit.

Kështu thuhet në njoftimin për medie të 21 dhjetorit të këtij misioni.

Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia, ka deklaruar se KFOR-i ruan aftësitë dhe mjetet e duhura për ta parandaluar dhunën në rajon dhe për të siguruar që ekzistojnë kushte që inkurajojnë dialogun e mëtejshëm politik ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit për të ecur përpara nën lehtësimin e Bashkimit

Evropian.

KFOR-i thotë se ka shtuar praninë në pikëkalimin kufitar në Jarinjë. “Ky shtim ishte i nevojshëm, duke pasur parasysh raportimet e fundit për praninë e supozuar të mundshme të grupeve të organizuara kriminale që ishin përfshirë në protesta”, thuhet në njoftim.

Më 18 dhjetor, në anën serbe afër Jarinjës - pikëkalimit kufitar mes Kosovës dhe Serbisë - është mbajtur një protestë e thirrur nga grupe djathtë serbe si shenjë mbështetjeje ndaj barrikadave që kanë ngritur serbët lokalë në veri të Kosovës. Barrikatat janë ngritur më 10 dhjetor në Jarinjë dhe Bërnjak në shenjë pakënaqësie ndaj arrestimit të ish-zyrtarit serb të Policisë së Kosovës, Dejan Pantiq.

Misioni i NATO-s thotë se nuk raportohet për të lënduar dhe se

“tensionet janë ulur” për shkak të koordinimit ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë dhe udhëheqjes së KFOR-it.

Në njoftim përmenden edhe stërvitjet e të fundit ushtarake, të mbajtura më 19 dhjetor, afër bazës që ka në Novosellë. Këto stërvitje u zhvilluan për t'i trajnuar dhe testuar aftësitë e njësive të KFOR-it për ta garantuar lirinë e lëvizjes, duke përdorur mjetet në dispozicion (automjete të rënda logjistike dhe mjete inxhinierike). “Për shkak të kompleksitetit të mjedisit aktual operativ, është thelbësore që këto sisteme dhe aftësi të testohen pasi ato zbusin rrezikun kolektiv nëse marrëveshjet e ardhshme politike nuk mund të përmbushen. Ka shumë aktorë në terren të përkushtuar për të bërë përparim, por KFOR-i mbetet vigjilent dhe i gatshëm për të reaguar. Ne jemi të

përgatitur të ndërhyjmë, nëse është e nevojshme, por ne parandalojmë përshkallëzimin në përputhje me mandatin tonë të OKB-së”, thuhet në njoftim.

Policia: Shpërthimet në Mitrovicë të Veriut dyshohet të jenë kryer me shok-bomba

Në Mitrovicë të Veriut mbrëmjen e 20 dhjetorit kanë ndodhur dy shpërthime, që dyshohet të jenë shkakuar nga hedhja e shok-bombave. Sipas policisë, njësitet patrulluese policore kanë raportuar se shpërthimet kanë ndodhur rreth orës 20:45 dhe 21:20 në Lagjen e Boshnjakëve dhe te Tre Rrokaqiejt. “Bazuar në informacionet e deritanishme, nuk është raportuar për ndonjë lëndim apo dëm dematerial”, thanë për “Radion Evropa e Lirë” nga zyra për informim e Policisë së Kosovës.

Ndërkaq, Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) tha se shpërthimi i 20 dhjetorit në Lagjen e Boshnjakëve ndodhi në afërsi të ekipit të televizionit “Tëvë1”.

“Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës shpreh shqetësimin e

thellë ndaj situatës së krijuar në veri të vendit dhe u bënë thirrje të gjithë kolegëve që të kenë kujdes të shtuar përgjatë raportimeve të tyre nga kjo pjesë. Njëherësh, AGK-ja kërkon nga organet kompetente t'i ndërmarrë masat e duhura që t'i sigurojë gazetarët ta kryejnë punë e tyre pa u rrezikuar e penguar”, thuhet në reagimin e AGK-së.

Sveçla: Rakiqi dhe bandat kriminale kanë bllokuar qytetarët dhe policët në veri

Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka akuzuar kryetarin e Listës Serbe, Goran Rakiq, se së bashku me “bandat kriminale e të armatosura”, po mirëmban barrikatat që, sipas tij, për 11 ditë rresht kanë bllokuar qytetarët dhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës. “Goran Rakiqi, në bashkëpunim me bandat kriminale e të armatosura, po i mirëmban barrikatat që kanë bllokuar qytetarët tanë dhe pjesëtarët e policisë së Kosovës tash e 11 ditë. E vetmja gjuhë që ata njohin dhe trumbetojnë janë vrasjet, ndërsa

OJQ-të nga Kosova dhe Serbia, thirrje për zëra konstruktivë për të ecur bashkë përpara

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Një grup prej 35 organizatash të shoqërisë civile nga Kosova e Serbia kanë bërë thirrje për zëra të rinj konstruktivë për të ecur bashkë përpara, për zëra që kërkojnë partneritete dhe koalicione përtej vijave të kuqe që supozohet t'i definojnë ato dhe për zëra që ngrihen publikisht "kundër retorikës përçarëse e poshtëruese". Në një komunikatë për medie, organizatat e kanë quajtur dështim të imagjinatës politike ciklin e vazhdueshëm të përshkallëzimit dhe depërshkallëzimit në raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Ky reagim vjen pasi më 10 dhjetor serbët lokalë ngrehën barrikada në pikëkalimet kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak si shenjë pakënaqësie ndaj arrestimit të një ish-zyrtari serb të Policisë së Kosovës. Ato kanë thënë se do t'i marrin përsipër kanalet e komunikimit që t'i zvogëlojnë mundësitë për keqkuptim dhe dezinformim. "Energjia që shpenzohet në përbalje me krizën e fundit shpërqendron nga tërësia e çështjeve urgjente që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e përditshme të qytetarëve në Serbi dhe Kosovë. Trendi tashmë ekzistues është që



njerëzit veçse po largohen nga Serbia dhe Kosova, veçanërisht të rinjtë. Ndërsa ngrihen barrikada të reja, aq dhe valixhe të reja mbushen. Shumë pak prej tyre ka gjasë të kthehen. E ardhmja e vendeve tona do të jetohet diku tjetër. Shumë grupe që

konsiderohen jashtë spektrit të dialogut Beograd - Prishtinë janë në themel të injoruar", thuhet në njoftimin e 35 organizatave nënshkruese.

Sipas këtyre 35 organizatave, deri tash më shumë është folur pa e kuptuar njëri-tjetrin, duke

këmbëngulur në rëndësinë e një pike dhe duke nënvlerësuar apo injoruar ekzistencën e një tjetre. "Vetëm duke ndarë perspektivat dhe perceptimet nga komunitetet tona përkatëse mund të fillojmë të ecim drejt një rruge të përbashkët për të ardhmen. Shumë nga

problemet me të cilat përballen komunitetet tona përkatëse janë pothuajse identike, megjithatë në rrallë e pranojmë këtë fakt", thuhet në komunikatë. "Nëse ka pasur ndonjëherë një kohë për solidaritet në dekadën e fundit, është kjo tani", kanë thënë 35 organizatat duke shtuar se lufta në Ukrainë është përkujtim i dhimbshim i realiteteve të zymta të luftës "edhe pse trashëgimitë tona mbeten të afërta".

Organizatat thonë se e ardhmja e Kosovës dhe e Serbisë janë të lidhura në mënyrë të pashmangshme me njëra-tjetrën dhe se "një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve është hapi i parë jetik në ndërtimin e një të nesërme më të mirë. Por është vetëm një hap i parë".

Kosova dhe Serbia kanë nisur negociatat për normalizimin e marrëdhënieve më 2011 me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Procesi i negociatave pritet të përfundojë me marrëveshje ligjërish të detyrueshme. Ndonëse Kosova deklaroi se kjo marrëveshje duhet ta përfshijë njohjen e ndërsjellë, Serbia nuk pranon, duke insistuar në "zgjdhje kompromisi".

QKSS-ja: FSK-ja, institucioni më i besueshëm nga qytetarët



PRISHTINË, 21 DHJETOR (ER) - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka publikuar raportin "Perceptimet publike për besimin, korrupsionin dhe integritetin e institucioneve publike në Kosovë" për vitin 2022.

Forca e Sigurisë së Kosovës është renditur institucioni më i besueshëm jo vetëm në sektorin e sigurisë, por edhe në krahasim me institucionet në kuadër të sektorëve të tjerë.

83 për qind e të anketuarve

kanë shprehur besim apo besim të plotë në FSK-në.

Institucioni tjetër që gëzon nivel të lartë besimi është Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave, me 73 për qind të të anketuarve që kanë shprehur besim ose besim të plotë.

Policia e Kosovës është renditur në vendin e tretë në mesin e institucioneve të perceptuara më pozitivisht nga të anketuarit, me 72 për qind që kanë shprehur besim apo besim të plotë në këtë

institucion.

Presidenca e Kosovës në këtë raport del se është institucioni i nivelit qendror me besueshmërinë më lartë prej 59-përqindësh të të anketuarve që kanë shprehur besim ose besim të plotë. Ndërsa Qeveria e Kosovës në këtë raport ka marrë vetëm 34 për qind të besimit të të anketuarve, teksa 46 për qind e tyre kanë deklaruar se kanë pak besim ose nuk kanë besim fare.

e vetmja gjuhë që ne njohim është stabiliteti, rendi dhe ligji ndaj të gjithëve dhe pa dallim. Ne jemi duke bërë përpjekje maksimale me partnerët tanë për heqjen e barrikadave pa asnjë eskalim të mundshëm, në ndërkohë këta po i armatosin bandat brenda barrikadave", ka thënë Sveçla, duke theksuar se nuk kanë mbështetje nga qytetarët serbë në aktet e tyre kriminale prandaj, sipas tij, tentojnë t'i frikësojnë me trillime për vrasje e për lista të paqena. "Nuk ka kompromis me krimin. Kushdo që në cilëndo formë ka cenuar sigurinë e vendit tonë do të ballafaqohet me drejtësinë. Kriminelët dhe qytetarët nuk janë në të njëjtën anë. Assesi nuk mund të kushtëzohet liria e lëvizjes dhe zhvillimi i të gjithë qytetarëve me lirinë e kriminelëve

që me aktet e tyre terroriste kanë rrezikuar, para së gjithash, të gjithë qytetarët pa dallim. Policia e Kosovës është një dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve në tërë territorin e Republikës së Kosovës si dhe në shërbim të ligjit që u kërkon llogaridhënie shkelësve të tij", ka deklaruar Sveçla.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë për "Guardian" se u kanë dhënë kohë trupave të KFOR-it për t'i larguar barrikadat, por ka shtuar se barrikadat nuk do të lejohen të qëndrojnë për një kohë të gjatë. "Shqetësimi ynë është se heqja e këtyre barrikadave nuk përjashton mundësinë e viktimave. Prandaj, ne duam që të jemi shumë të kujdesshëm që të sigurohemi që të mos ketë destabilizim dhe do të ketë paqe dhe siguri", ka thënë Kurti.



PSD-ja kërkon amendamentimin e Ligjit për Gjykatën Speciale

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Partia Socialdemokrate (PSD) u ka dërguar shkresa deputetëve të Kuvendit të Kosovës që t'i nisin procedurat për amendamentimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara në Hagë, e njohur si Gjykata Speciale. Me këtë rast, kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka thënë se Kuvendi i Kosovës duhet të ndryshojë përmes amendamenteve nenin 6 dhe nenin 16 të këtij ligji. "Sot iu kemi drejtuar të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, përjashtojmë ata të Listës Serbe, për t'u bërë pjesë e grupit, i cili do të duhej të ndërtohej nga deputetë për ta filluar amendamentimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara. Ne konsiderojmë

se janë dy nene shumë problematike që nuk janë në përputhje me ligjin ndërkombëtar për krime lufte dhe konventat ndërkombëtare për krime lufte. Njëri ka të bëjë me konventën lëndore që e trajton subjektin e ndjekjes nga kjo gjykatë e që është trajtimi prej bazës së nenit 6 ku ndiqen vetëm krimet e UÇK-së. Prandaj ne besojmë se kur krimet ndiqen vetëm prej njëres anë ose njëetnike, ajo nuk ka të bëjë me drejtësi, por padrejtësi. Rrjedhimisht duam ta ndërrojmë e ta kthejmë këtë gjykatë që të sillte drejtësi. Neni i dytë që duam ta riformulojmë është ai 16 mbi përgjegjësinë individuale dhe komanduese në veprimet e supozuara që mund të kenë ndodhur", është

shprehur Molliqaj.

Më tutje, Molliqaj ka thënë se deputetët duhet të jenë në nivel të detyrës, duke shtuar se populli i Kosovës nuk i duron padrejtësitë e Gjykatës Speciale. "Sot u bëj thirrje të gjithë deputetëve që të jenë në nivelin e detyrës, pasi ata janë përfaqësues të popullit të Kosovës. Populli është i qartë se nuk e duron këtë padrejtësi që vjen nga Gjykata Speciale. Besoj se ta shtunën do të jemi masivisht në sheshet e Prishtinës për të treguar se të gjithë jemi kundër kësaj", ka thënë ai.

PSD-ja të shtunën organizon protestë kundër Gjykatës Speciale pas dënimit të ish-pjesëtarit të UÇK-së, Salih Mustafa, me 26 vjet burgim.



KKSB-ja në Gjilan u bënë thirrje qytetarëve të festojnë pa armë e pa mjete piroteknike



GJILAN, 21 DHJETOR - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), në takimin e fundit për këtë vit, kryesuar nga nënkryetarja e komunës, Leonora Morina-Bunjaku, e ka vlerësuar të mirë gjendjen e sigurisë në Gjilan, ndërkohë që ka kërkuar nga qytetarët të festojnë kujdesshëm gjatë festave të fundvitit, pa përdorim të mjeteve piroteknike dhe pa të shtëna armësh.

Për më tepër, nënkryetarja Morina-Bunjaku ka thënë se kryetari i komunës, Alban Hyseni, ka nxjerrë një urdhëresë

që ndalon përdorimin e mjeteve piroteknike, e cila është përcjellë edhe me materiale vetëdijesuese, duke kërkuar nga anëtarët e KKSB-së që edhe ata të ndikojnë në respektimin e kësaj mase në mjediset prej nga vijnë në mënyrë që të sigurohet një ambient i qetë për të gjithë qytetarët.

Përndryshe komandanti i Stacionit të Policisë, Agim Lipovica, ka paraqitur një informatë të hollësishtme sa i përket sigurisë në komunën e Gjilanit gjatë vitit 2022, duke nënvizuar faktin se gjendja e

përgjithshme ka qenë shumë e mirë, për çka meritat më të mëdha i ka adresuar te qytetarët. Sa iu përket statistikave, gjatë vitit 2022 vërehet një rënie e lehtë e numrit të përgjithshëm të krimeve, derisa inkurajues është niveli i zbulimit të rasteve. Edhe te dhuna në familje ka një rënie të lehtë të rasteve në krahasim me vitin paraprak, ka thënë Lipovica, duke nënvizuar se në rreth 50 për qind të rasteve bëhet fjalë për persona të njëjtë, që janë përsëritës të veprës.

Njësia e Deminimit e FSK-së furnizohet me pajisje të reja

PRISHTINË, 21 DHJETOR - "Miqësia me Republikën Federale të Gjermanisë rrjedh natyrshëm si lidhje nga e kaluara që vazhdon të thellohet me bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet të dy shteteve, dëshmi e së cilës është ndihma e vazhdueshme që pranojmë nga ky shtet, ashtu siç edhe sot pranuar donacionin me pajisje të deminimit nga ana e shefit të Mbrojtjes të Ushtrisë gjermane, gjeneral Eberhard Zorn", ka thënë ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, duke bërë me dije se në takim me shefin e Mbrojtjes së Gjermanisë biseduan rreth fushave specifike ku mund të rritet bashkëpunimi, me theks të veçantë në logjistikë, në fushën e mjekësisë dhe në trajnime të përbashkëta që do të shërbejnë për ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe operacionale të ushtarakëve. "Gjeneralin e njoftova rreth aktiviteteve që FSK-ja është duke zhvilluar sa i përket përgatitjeve për Defender '23, si shtet nikoqir



i këtij ushtrimi fushor por, gjithashtu, edhe për gatishmërinë që kemi shprehur për ofruar trajnime për ushtarakët ukrainas. Mes të tjerash, gjeneralit i ofrova bashkëpunim në fushën e shkëmbimit të informacioneve dhe në zhvillimin e ushtrimeve të përbashkëta në terrenet tashmë të shpronësuar në

hapësirën e ish-Aeroportit të Gjakovës, në Cernushë dhe Babaj të Bokës", ka thënë Mehaj. Ai ka theksuar se edhe një herë ka shprehur rëndësinë e investimit të kompanive gjermane në industrinë e mbrojtjes në Republikën e Kosovës dhe synimin që si ushtri dhe si shtet kanë për t'u anëtarësuar në NATO dhe BE.



Kryeqytetit i shtohen dy kënde lodrash për fëmijët me aftësi të kufizuara

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Mission in Kosovo dhe YARL-Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se kryeqytetit i janë shtuar dy kënde lodrash të qasshme për fëmijët me nevojë të veçanta. Ai ka falënderuar partnerët e komunës së Prishtinës OSCE

Mission in Kosovo dhe YARL-Youth are the real leaders për realizimin e këtij projekti shumë të nevojshëm. "Qasja e barabartë për të gjithë qytetarët është prioriteti ynë. Jemi në hapat e duhur drejt Prishtinës për të gjithë", ka thënë Rama.

Bëhen përgatitjet e fundit për ta lëshuar në funksion tomografinë e kompjuterizuar për simulimin e pacientëve

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Në Repartin e Radioterapisë të Klinikës së Onkologjisë po bëhen përgatitjet e fundit për ta lëshuar në funksion tomografinë e kompjuterizuar për simulimin e pacientëve (CT

Simulator). CT Simulatori i ri është dora e fundit e teknologjisë, i cili është blerë nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës dhe ka kushtuar 345 900 euro. Ky sistem identifikon automatikisht trupat e huaj

në organizëm dhe bën korrigjimin e kualitetit të imazheve. Gjithashtu, kjo pajisje është komplet automatike, e pajisur me fantom kalbrim dhe përmban protokolle specifike.



Hoti: Njohja nga Izraeli ka hapur dyert e reja të bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Izraelit

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, së bashku me anëtarët e grupit të miqësisë Kosovë - Izrael, kanë pritur në takim ambasadorin e Izraelit, Tamara Ziv dhe me drejtorin për vendet e Ballkanit, përfshirë edhe Kosovën, ambasadorin Dan Oryan. "Takimin e filluam me urimin për festën Hanukkah dhe urova që kjo festë t'i gjej të lumtur dhe të bashkuar të gjithë besimtarët. Në këtë takim biseduam për arritjet që kemi bërë nga njohja e pavarësisë së Republikës së Kosovës nga Izraeli dhe deri tek arritjet konkrete të njohjes që kanë rezultuar edhe me binjakëzim të komunave", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Ai ka theksuar se njohja nga Izraeli që është bërë gjatë qeverisjes së tij sa ishte kryeministër ka hapur dyert e rëndësishme për qytetarët dhe bizneset që të shkëmbejnë përvoja diplomatike, shoqërore, kulturore, arsimore dhe biznesore me një shtet sikur Izraeli. "Është fat për Kosovën që ka miqësi me Izraelin", ka deklaruar Hoti.



Vazhdon gjurmimi dhe identifikimi i aseteve të fituara në mënyrë të paligjshme



PRISHTINË, 21 DHJETOR - Ushtuesi i detyrës i kryeprokurorit të shtetit, Besim Kelmendi dhe drejtoresha e Institutit të Bazelit për Qeverisje (IBQ), Gretta Fenner, kanë nënshkruar memorandum për vazhdimin e bashkëpunimit lidhur me gjurmimin dhe identifikimin e aseteve të fituara në mënyrë të paligjshme, që ka për qëllim rritjen e efikasitetit në luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimit të organizuar në Republikën e Kosovës.

Ky partneritet do vazhdojë t'u ofrojë prokurorëve të shtetit ekspertizë ligjore ndërkombëtare

për rastet e korrupsionit, krimeve financiare dhe krimit të organizuar përmes asistimit të tyre në gjurmimin e pasurive të fituara në mënyrë të kundërligjshme.

Nënshkrimi i këtij memorandumi është vazhdimësi e marrëveshjes së 23 shtatorit 2020 ndërmjet institucionit të Prokurorit të Shtetit dhe Institutit të Bazelit për Qeverisje (IBQ), i cili është mundësuar nga Zyra e UNDP-së në Kosovë, në kuadër të Projektit SAEK III, projekt ky që mbështetet financiarisht nga qeveria zvicerane dhe ajo suedeze.

Kosova strehon gazetaren e 13-të nga Ukraina

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Në Kosovë ka mbërritur gazetarja e radhës ukrainase, Anastasiia Poia. Poia do t'u bashkohet gazetareve ukrainas tanimë të strehuar në vend, në kuadër të

programit "Journalists in Residence - Kosovo". Kolegia ukrainase është mirëpritur në aeroport nga drejtoresha ekzekutive e AGK-së, Getoarë Mulliqi Bojaj, përfaqësues të MPB-së

dhe Policisë së Kosovës. AGK-ja shpreh sërish mirënjohjen për të gjithë partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë që ndihmuan implementimin e projektit përgjatë vitit.



Si u shndërrua Brezovica në skemë korrupsioni

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Në vitet '90 fshati Brezovicë në pjesën jugore të Kosovës ishte një prej qendrave më atraktive për turizëm dimëror. Tri dekada më vonë kjo qendër e skijimit është shndërruar në një prej aferave më të mëdha të korrupsionit që po heton Prokuroria e Kosovës.

Qindra ndërtime pa leje, degradim i ambientit, dhënie dhe marrje e ryshfetit janë vetëm disa prej veprave penale për të cilat Prokuroria Themelore e Ferizajt ka ngritur dy aktakuza kundër 20 personave.

Të akuzuarit përfshijnë Bratislav Nikolliqin, ish-kryetar i komunës së Shtërpçës, ku edhe ndodhet Brezovica, pastaj drejtorë komunalë, zyrtarë të Ministrisë së Mjedisit, ndërtues dhe persona të tjerë që kanë ndihmuar apo kanë dhënë ryshfet në këmbim të lejeve të ndërtimit.

Për këtë rast, në të cilin janë hetuar rreth 100 persona, prokurori Rasim Maloku jep detaje për "Radion Evropa e Lirë". Mes të tjerash, tregon se si Nikolliqi, si kryetar i Shtërpçës, ka dhënë jashtëligjshëm leje për ndërtim në Brezovicë në këmbim të ryshfetit, se si inspektorët komunalë nuk i kanë ndaluar punimet dhe se si zyrtarë të Ministrisë së Mjedisit kanë neglizhuar punën e tyre në raport me degradimin e Parkut Kombëtar "Shari" në Brezovicë. Maloku, po ashtu, flet për përpjekjet e Millan Radoičiqit - nënkryetar i partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, Lista Serbe - që t'i pengojë hetimet përmes frikësimit të dëshmitarëve.

Radoičiqi është në arrati dhe kërkohet për frikësimin e dëshmitarëve pikërisht në rastin e Brezovicës. Ai, gjithashtu, dyshohet se ka lidhje me vrasjen ende të pazbardhur të politikantit të opozitës serbe në Kosovë, Oliver Ivanović, në janar të vitit 2018, ndërsa ShBA-ja e ka futur në listë të zezë për shkak të dyshimit për përfshirje në krimin ndërkombëtar.

Sipas prokurorisë, nga viti 2013 deri në vitin 2022 në Brezovicë janë ndërtuar më shumë se 100 objekte në mënyrë të jashtëligjshme. Për ndërtimin e tyre prokuroria thotë se janë dhënë më shumë se 2 milionë euro ryshfet.

Në aktakuzën e parë që është ngritur në vitin 2020 janë përfshirë 11 persona, kryesisht zyrtarë komunalë, ndërtues dhe pronarë objekteve pa leje.

Pas një hetimi të gjatë, Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngritur aktakuzë kundër 11 personave të dyshuar për keqpërdorim të pozitës për ndërtime pa leje, për degradim të natyrës si dhe për shkelje të ligjeve të tjera. Këto vepra lidhen me ndërtimin e dhjetëra vikend-shtëpizave dhe hoteleve në Brezovicë.

Prokurori i rastit, Rasim Maloku, thotë se sa më shumë që është gjurmuar në këtë rast, aq më shumë janë zgjeruar hetimet. Kjo,

sipas tij, ka çuar në ngritjen e aktakuzës së dytë më 9 nëntor të vitit 2022. Në të, ish-kryetari i Shtërpçës, Nikolliqi, përshkruhet si njeriu kryesor që ka marrë ryshfet në këmbim të dhënies së lejeve të ndërtimit në zonat e mbrojtura të Parkut Kombëtar "Shari" në Brezovicë.

Në aktakuzën e dytë, përveç Nikolliqit, është përfshirë sërish edhe drejtori i Urbanizmit, ashtu si edhe dy inspektorë komunalë, drejtori i Kadastrës në Shtërpçë dhe të tjerë.

Ish-kryetari i Shtërpçës, Bratislav Nikolliqi, dyshohet se ka marrë më shumë se një milion euro ryshfet nga kompanitë ndërtuese dhe investitorët. Sipas aktakuzës, ai ka qenë personi kryesor nga viti 2013 deri më 21 dhjetor 2021 që ka ndikuar direkt në dhënien e lejeve ndërtimore.

Vetëm në një rast, sipas aktakuzës, Nikolliqi dyshohet se ka mundësuar dhënien e lejeve ndërtimore në Parkun Kombëtar "Shari" dhe përmes personit përgjegjës të ndërmarrjes "Quka Co", Alban Quka, i cili do ta kryente ndërtimin, ka marrë 210 000 euro për 21 leje ndërtimore të vikend-shtëpizave për investitorin "Stella Consulting", si dhe 200 000 euro të tjera për lejen ndërtimore të objektit hotelier "Stela Consulting".

Me gjithë përpjekjet, "Radio Evropa e Lirë" nuk ka arritur të bjerë në kontakt me pronarin e kompanisë "Quka Co", as me pronarë të tjerë të kompanive ndërtuese si dhe me investitorë që dyshohen për dhënie të ryshfetit. Në hetim aktiv për këtë rast aktualisht janë edhe 40 persona, por prokurori i rastit, Rasim Maloku, nuk dëshiron të japë më shumë informacione se për kë bëhet fjalë apo për çfarë dyshohen ata.

Për çfarë akuzohen zyrtarët komunalë?

Në aktakuzë thuhet se Nikolliqi ka qenë personi kryesor që ka vendosur se kujt t'i lëshohej leje ndërtimi. Sipas aktakuzës, dhënien e lejeve në disa raste e ka mundësuar drejtori i Urbanizmit në Shtërpçë, Dimitrije Raçiçević. Ai akuzohet se në bashkëveprim me dy inspektorët komunalë, Hysni Bajrami dhe Dragomir Millosavljeviq, nuk i kanë përmbushur detyrat zyrtare, gjegjësisht nuk kanë ndaluar ndërtimin e objekteve në zonat e ndaluara për ndërtim me qëllim të përfitimit pasuror për vete. Sipas prokurorisë, në disa raste ata kanë marrë shuma nga 5 mijë euro, ndërsa në një rast tjetër 14 mijë euro.

I përfshirë ka qenë edhe drejtori i Kadastrës në Shtërpçë, Sasha Millosavljeviq. Ai akuzohet se ka marrë para nga kompani ndërtuese dhe persona të tjerë fizikë në këmbim të sigurimit të dokumentacioneve të nevojshme si dhe të lejeve të ndërtimit.



Për çfarë akuzohen zyrtarët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor?

Në aktakuzë zyrtarët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Kosovës (MMPH) nuk akuzohen për marrje të ryshfetit. Akuzat që ngarkohen mbi ta kanë të bëjnë me keqpërdorim të detyrës zyrtare me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për tjetrin. Sipas aktakuzës, ish-sekretari i MMPH-së, Arben Çitaku, ka nxjerrë vendim për dhënien e pëlqimeve mjedisore për disa objekte që janë ndërtuar jashtëligjshëm në Brezovicë. Për mospërmbushje të detyrave akuzohet edhe kryeinspektori i kësaj ministrie, Bedri Halimi, i cili, sipas prokurorisë, nuk ka ndërmarrë veprime ligjore-ekzekutive për ta ndaluar ndërtimin e vikend-shtëpive dhe hoteleve, edhe pse ka qenë në dijeni se ato kanë qenë duke u ndërtuar pa pëlqime mjedisore.

Avokati mbrojtës i Bedri Halimit, Haxhi Millaku, thotë për "Radion Evropa e Lirë" si klienti i tij nuk e ndien veten fajtor për asnjë nga akuzat me të cilat ngarkohet. "Në qoftë se dikush nuk ka vepruar, atëherë janë organet e ndjekjes, përkatësisht prokuroria kompetente që tash po ushtron akuzë kundër një njeriu që asnjë veprim apo mosveprim të kundërligjshëm nuk e ka", thotë Millaku.

Shtatëdhjetë e pesë objekte të sekuestruara përkohësisht

Nën dyshimet se janë ndërtuar jashtëligjshëm, deri më tani janë sekuestruar 75 objekte në Brezovicë. "Këto vila janë konfiskuar për faktin se kanë qenë të ndërtuara në një zonë të mbrojtur, ku ndalohet rreptësisht ndërtimi", thotë prokurori Maloku.

Në mesin e personave që u janë konfiskuar vilat janë tre gjyqtarë, politikanë, biznesmenë, si dhe qytetarët që i kanë blerë ato - disa prej tyre, me gjasë, pa qenë në dijeni se janë ndërtuar jashtëligjshëm.

"Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar disa pronarë që u janë konfiskuar vilat, por shumë prej

tyre ose nuk kanë qenë të qasshëm, ose nuk kanë dashur të flasin, me arsyetimin se me rastin po merret prokuroria.

Ndërkaq biznesmeni Shaqir Palushi, të cilit i është sekuestruar një vikend-shtëpizë në Brezovicë, thotë se e ka blerë atë në nëntor të vitit 2021 për një shumë rreth 200 000 euro dhe se shitësi ia ka dëshmuar i ka të gjitha lejet e nevojshme.

Palushi thotë se nuk ka qenë në dijeni se ajo është ndërtuar në zonën e Parkut Kombëtar "Shari", ku ndërtimi është i ndaluar me ligj. "Është e pajisur me leje ndërtimi, të lëshuar nga komuna e Shtërpçës në vitin 2017. Unë s'kam pasur asnjë njohuri dhe asnjë lidhje. Dhe, sigurisht, jam pro dënimit të personave përgjegjës nëse kanë bërë shkelje, por mendoj që në rastin tonë... dhe, sa e di, të paktën edhe disa të tjerë, që janë fqinjë me vilën tonë... ne nuk e kemi as më të voglin faj", thotë Palushi për "Radion Evropa e Lirë".

Prokurori i rastit, Maloku, nuk e përjashton mundësinë që disa nga pronarët të mos kenë qenë në dijeni për shkeljet ligjore. Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ai jep një çmim të përafërt të vilave të ndërtuara në zonat e ndaluara në Brezovicë.

Pengimi i hetimeve

Brezovica ndodhet në komunën e Shtërpçës, e cila shumicën e popullatës e ka të nacionalitetit serb. Komunën e kanë udhëhequr tradicionalisht përfaqësuesit politikë serbë - përfshirë kryetarin e komunës dhe shumicën e drejtorive.

Hetimet në këtë rast, sipas prokurorit Maloku, i kanë vështirësuar strukturat paralele serbe që veprojnë në Kosovë, të mbështetura nga shteti i Serbisë. "Për çdo aktivitet që e kemi zhvilluar në zonën e Brezovicës, kemi qenë të monitoruar nga strukturat ilegale dhe kjo e ka cenuar në një mënyrë edhe sigurinë, por edhe vetë hetimin në këtë çështje", thotë Maloku.

Pikërisht për rastin Brezovica, nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoičiq, ka urdhërrarrest aktiv dhe ndodhet në arrati. Pas nisjes së hetimeve në këtë rast, Radoičiqi dyshohet se ka ndikuar te dëshmitarët bashkëpunues,

duke i kërcënuar dhe frikësuar ata që të mos bashkëpunojnë me prokurorinë.

Prokurori Maloku thotë se ka dyshime të bazuara që mjetet që janë marrë në formë ryshfeti nga zyrtarët komunalë në Shtërpçë, në këmbim të dhënies së lejeve të ndërtimit, në disa raste kanë shkuar për financimin e subjektit politik, Lista Serbe - pjesë e së cilës parti është edhe ish-kryetari i Shtërpçës, Nikolliqi.

Prokurori Maloku thotë se në bazë të hetimeve ka dyshime të bazuara se shuma të mëdha të parave janë dërguar përmes transaksioneve fiktive nga Kosova në Serbi.

Kërkohet trajtim me prioritet nga gjykata

Aktakuza e parë kundër 11 personave në rastin Brezovica është dorëzuar në gjykatë në vitin 2020, por deri më tani nuk ka filluar procesi gjyqësor.

Drejtori ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi, Ehat Miftaraj, thotë se në këtë rast gjykata duhet të veprojë me prioritet, pasi të përfshirë janë njerëz të profileve të ndryshme. Dhe, sipas tij, mund të ketë prej atyre që do të përpiqen të gjejnë rrugë alternative për t'i shpëtuar drejtësisë.

"Sistemi gjyqësor, si dhe ai prokurorial, do të duhej që, në radhë të parë, t'u ofronin mbështetje gjyqtarëve dhe prokurorëve në këtë rast, që t'i ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në mënyrën më të pavarur të mundshme, por që edhe prokurori i shtetit të ndërmarrë masa ndaj secilit që, përmes mënyrave të kundërligjshme, tenton të ndikojë në këtë rast", thotë Miftaraj për "Radion Evropa e Lirë".

Në raportin e publikuar në janar organizata ndërkombëtare Transparency International ka vlerësuar se Kosova ka shënuar përparim të lehtë në luftën kundër korrupsionit.

Derisa rasti i Brezovicës mbetet ende nën hetim dhe në pritje të nisjes së seancave gjyqësore, prokurori Rasim Maloku thotë se nuk e di se cili do të jetë rezultati final - do të rrënohen apo jo vilat dhe hotelet e ndërtuara jashtëligjshëm në Brezovicë.

BISEDË ME HYSEN TËRPEZËN (2)

Të gjithë e dinin që unë me serbë nuk punoj

Aty, kur e morët abetaren, çka u bë pastaj?

– E mora abetaren e i mësoja geramat me rend.

Nuk na treguat hiç për punën e dasmës. Kur u martuat, a u martuat në Shqipëri, a ku? A u gëzua nana shumë?


– Nusen e mora prej Sllatine. Me mësit e kam nxjerrë. Ai mësi ka qenë prej Zllatarit. Ishte plak.

Sa vjeç keni qenë atëherë?

– Tamam njëzet vjeç kam qenë. Kishim fukarallëk shumë. Kur jam martuar, me çka kanë mundur na kanë ndihmuar mëhalla e katundi! Me tesha të huaja kam hyrë dhëndër. Ishim fukarenj të lodhtë. As çejz, thuaja hiç. Me do tesha të vjetra. Kur kam hyrë dhëndër me tirq me arna kam qenë. S'kanë shkuar tre-katër vjet dhe unë nisa të merresha me duhan e u bëra zotni. Puna të qet në dritë. Asgjë nuk kemi pasur. Pastaj e martova Ahmetin, mbas tre vjetësh. Bile, kur u martua, i kemi çuar nja pesë a gjashtë veta. Baci Selim e ka pru një zog pule për ata njerëz.

Mbasi e rregulluat punën me italianë, si kalonit?

– Pata një konflikt me italianë. Ka qenë një shqiptar i Kaçanikut. Ai i kish marrë dy djem të Pozharanit, pse ishin ankuar dy djem të shkive. Kur erdhi ai në komunë mua nuk më bëri hesap hiç. Po i thotë sekretarit: Ju jeni të poshtëri! I kish marrë do djem të rinj. Unë i marr tash e jau jap 100 druna. I thashë çka po flet bre zotni? S'ka burra, tha, në Kosovë. Unë i thashë ka burra që i ka koçet sa qeky. Ti në kohën e Jugosllavisë ke ikur prej Kosove në Shqipëri. E tash prej Shkupit ke ardhur këtu. Ti punë nuk ke këtu. Unë komandoj këtu. E kam pasur alltinë në shokë. Një bombë këndeje. E kapa bombën në dorë. Ai ka dalë përjashta. Ka dalë edhe një tjetër italian. E qita për dritare bombën në udhë. U bë një hallakamë aty. Ai ka dalë duke bërë titur aty nëpër kafe. Thotë një njeri i trentë ishte aty në komunë. Ikën krejt. Janë çuar Pozharani! E kanë marrë Musli Pirën e Shabanin e Halitit, plak, e kanë ardhur. Mbasi janë italianët, nuk duhet të nervozohen, se e kallin krejt katundin. Po më thonë mua, deri të merremi vesh, ti ta lësh komunën dhjetë ditë. U thashë unë shkoj prej komune kur t'i dalin copat në xhade. Nuk e lëshoj komunën i gjallë. Janë mbledhur krejt, po i



qita përjashta, i përzura krejt. Ka qenë një Zabrinë i Shkodrës aty. Kish qenë burrë i mirë. Më ka dashur shumë. Shkova në Prishtinë. Ai më donte mua shumë, po italianët nuk i donte hiç. Ai ish prefekt dhe ai e kishte punën në dorë. Po, dy-tri herë kanë dashur të më përzënë këta të Pozharanit. Erdhën katundi krejt. Një Mustafa i Shabanit tha: Ti këtu, ne këtu, jo! Ti këtu, ne në mal krejt!

U thashë unë jam i malit edhe i këtuhit. Me vota nuk ma keni dhanë detyrën. Detyrën ma ka dhënë hyqymeti. Më rrethuan në tavolinë. Çohu dil ikë prej këtu! Një Sadiku ka qenë. Ka vdekur. I Alidemajve ka qenë. I kisha edhe nja gjashtë policë. Sadiku ka qenë përjashta diçka. Kur ka hyrë në derë, i ka parë kallaballëk nja 10 veta. Ka hyrë e ua ka drejtuar pushkën. Mustafën e kish të vëllanë e babës, mixhë. Hajt, u tha, he nanën... Të gjithë kanë dalë përjashta. Kanë shkuar te togeri. Ai nuk ka ardhur të ma bëjë për hair e djali i tij po. Kallëzuan

krejt. E t'i ka rrokur të tanë Hamdiu përpara. A jeni në mend? – u ka thanë. Kur ka ardhur nuk e linit të shkonte në shtëpi. I keni dhënë darkë e drekë. Cakiçi ka vënë rregull. Kur nuk ishte këtu e dini si ka qenë. Ai i ka thanë këtij Pirës, e futa edhe djalin tim, po ai vetëm nja pesë ditë, s'bëri, si një mut. Të futa ty, edhe ti si një bajgë. A është ky djali i Sahit Terëpezës? Kur ishe ti, italianët i gjeje në oborr. Ai po thotë kurrë nuk i lëshoj. Unë do t'i mbaj ata. Kur, s'po di, në aksham erdhi një djalë i tij, Rexhep e ka pasur emrin. Ai ishte 13 vjeç. Më tha se e kishte porositur axha të më thërriste. Shkova. Kur kam hyrë në derë u çua në këmbë e ka thënë byjrum Cakiç. Ulu, të kërkoi falje, se kam bërë një gabim. Qe 6 a 7 muaj nuk kam ardhur të të shoh. Po thotë, edhe nëse do të rrih ku të dish sa, nuk do të guxojë kush të të prekë me dorë. Këta janë të poshtëri. Thoshin s'mund e mban ky as tri ditë. Tre vjet e mbajta. Krejt me gjoks e kam mbajtur.

Ne e kemi shumë keq. Edhe sot duket njashtu. Thonë kanë qitur pushkë e kanë luftuar. Unë vetë kam bërë apel për të ndihmuar. Çuditë qysh i dolëm kështu në skaj. Po unë kam qëndruar me forcë. Edhe amerikanët e panë që s'kam frikë. Më panë që unë jam trim. Kam bërë edhe budallallëqe. Diku në '83-n paska thanë dikush se Hysen Tërpeza u pa në Ambasadën Jugosllave në Tiranë. Ka pas diçka, bre mixhë, se të kishin thënë edhe ty. Unë kisha qenë dhe kisha ndenjtur shtatë a tetë ditë në Shqipëri. I kam ra rrezikut. Shtatë vjet janë munduar të ma mbushin mendjen të shkoja. Kur mbaroi lufta më 1945, fitoi Rusia. Detin e Zi e zuri Rusia. Edhe amerikanët dy herë i kanë dhënë zor të më pajtonin me Serbinë. Tybe istikfa, po më vjen ligësi ta them. Pranoj ta vras veten e me Serbi nuk pranoj. Pak shqiptarë ka pa hile. Kam parë njerëz të mëdhenj që po më vjen vështirë ta them, bre! Çifti i Muharrem Bajraktarit e

Abaz Kupit. Rexhep Krasniqi, si kosovar. Të gjithë të Shqipërisë më...

Siç e dini, Ahmet Zogu pat ikur në Angli. Pasi ish në Egjipt mbreti Faruk, e thirri atje. Xhafer Deva kishte ikur më vonë në Suedi. Po edhe këtë e kanë thirrur në Egjipt. Kam kontaktuar më vonë me këtë.

Mua më akuzuan se i kam luftuar tri shtete: Bullgarinë, Serbinë e Shqipërinë.

Si kaluat më pastaj në Pozharan?

– Mirë. Veç në atë fillim, se më nuk kam pasur probleme. Më kapën italianët. Ndenja në Prizren nja 9 ditë në burg. Fadili më futi. Qysh në të '41-shin, si ka marrë vesh që kam ardhur në komunë, ka ardhur vetë i treti tek unë në shtëpi: Fadil Hoxha, Kurtesh Agushi me shkollë dhe njëfarë Xheledini i Kumanovës. Pat ardhur edhe Rifat Berisha. Në Gjilan, kur shkova, e gjeta Fadilin te Rifati. Thashë çka u bë kështu? Fadil Hoxhën e çuan mësues në Hogosht, Kurtesh Agushin kryetar komune në Kamenicë. Këta të dy kishin qenë të lidhur me serbë aty menjëherë.

Një mbrëmje, një djalë me një biçikletë erdhi para komune. Dera ishte hapur. Hyri një polic e më tha: Po do të vijë një djalë. Kur erdhi ma lëshoi në dorë një letër, të shkruar me dorë, me germa të shtypit. I pata mësuar do germa me atë abetaren. Aty në letër po thonë: Sonte vijnë te ti tre veta, priti mirë. Kur shkova ata kishin ardhur para meje. Kurteshin e njihja edhe përpara. Fadilin sefte e pashë. Xheladin Kurbalia ishte i treti. Mbasandaj atë e kanë prerë në konak, në Muçibabë. Trim ka qenë boll ai. U ktheva darkë. Fadili thoshte diçka. Po m'i thotë do gjëra komuniste, se do të jetë kështu e kështu, ku flitet shqip do të jetë Shqipëri. Do të jemi të lirë. Më duket dy net kanë ndenjtur. Unë veç po dëgjoja e po çuditesha. I thashë se ata të thonë ashtu, por jemi në Jugosllavi, o Fadil. I thashë se nuk e përgjak dorën me gjak shqiptari. Jam i bindur, i thashë, se serbët do të bëjnë çmos për të mos e lëshuar Kosovën. Do ta shohësh që do të na tradhtojnë. Sa për ju, nuk ju prek. Tha që t'u jepja ndonjë copë bukë atyre (partizanëve). Mos i vrit! Nuk i ka ngucur kurkush. Ashtu ka shkuar lëmsh. Hasan Remniku nuk ka qenë komunist, po nacionalist i madh. Po ai i pat vrarë do kesi të mëdhenj, veç kapetana. Ai i ka vrarë

ata që duheshin vrarë. Në Remnik, kur ka hyrë bullgari, kanë futur në dhe të gjallë shqiptarë. Mbasandaj Hasani i nxori këto haqe krejt. Bullgari andej Morave, këndeje Italia.

A morën vesh italianët që e ke pritur Fadilin?

– Jo, jo!
Në të '43-shin Fadili u rrethua në Gjilan, në Livoç të Epërm, që edhe sikur të kishte krahë, nuk do të mund të shpëtonte. Na telefonoi Rifat Berisha: Mulne, se ke qysh ke, ata janë shqiptarë e të shpëtojnë prej italianëve. Kur ta shpëtoj i bie ndër mend që e ka gabim a diçka. Edhe Ramiz Cërrnicës i kanë telefonuar. Ramizi kish qenë afër. E ka rrethuar. Edhe unë i thirra policët në Sllakoc. Kisha njerëz të njohur dhe më kanë dëgjuar çka u kam thënë. U rrethua në 9, në sabah. Ishte data 15 e muajit maj. Puna e kaçakut, për të shpëtuar, duhet të jetë veç natë. Po qe ditë, kaçaku nuk shpëton. Kemi shkuar e i kemi rrethuar me mijëra njerëz, a vullnetarë, a policë, a italianë. Edhe paria!

Fadili, a ishte ilegal në brigadë?

– Po, more, ilegal ishte! Me 34 shokë ka qenë.

A bënte luftë ai Fadili?

– Po, qysh jo! Bënin propagandë ku u zatetshin. Pasi u bë aksham e thirrën Fadilin për të biseduar me mareshalin italian. Donin të humbnin kohë deri të bëhej aksham. Dua t'i pyes shokët, kështu e kështu. Dita ishte e gjatë. Kur u bë aksham, krisi pushka. Një u vra prej shokëve të Fadilit. U vra njëri i Sllakocit duke u bartur ujë vullnetarëve. Prej tanëve nuk u vra kurrkush.

Ishte një luginë e madhe, veç shkëmb. Aty, veç me avion po të ishin, se nuk shpëtonin. Unë u thashë, le të ikin, por ju mos i vritni. Në një rast, katër shokë të Fadilit, djem të rinj, bien në pritë të do njerëzve të Sllakocit. Aty ata i çarmatosin dhe dikush thotë se na ka thanë kryetari të mos i vrasim. Nejsë, nuk i kishin vrarë, por armët ua kishin marrë. Të nesërmen, kur shkova në komunë, e kuptova krejt. Qenkan mbledhur në Presedel. Atyre u kanë thënë se Hyseni po na mban qe tre vjet me bukë. I kishin çarmatosur e armët i kishin pru, ndërsa ata i kishin lëshuar. Na duheshin pushkët, se lufta shkonte flakë.

Po Mulla Idrizi?

– Ishte në Gjilan. Po edhe ai ishte me shokë të vet. Jam takuar edhe me të në Hogosht. Më ka dashur shumë. Më shumë kam jetuar në Hogosht se në atë komunë. Aty u çonin edhe kazanët për ushqim. Aty ua kanë falë dikush një mëzat, dikush diçka për të therur, dhe duhej të mbaheshin, se lufta kallej në të gjitha anët. Duke mbledhur ndihma, për t'i mbajtur ata, zor ka qenë! Atje mal ka boll. Dru kishin.

A të njoftoi ai që e kanë ditur italianët se i kanë lëshuar këta shokët e Fadilit?

– Këta ua kanë ndaluar pushkët e i kanë lëshuar ata të Fadilit. Fadili me shokë është tërhequr. Janë takuar në Presedel pastaj. Mbas është bërë natë kanë shpëtuar. Në luftë e linin një vend të caktuar, se kur duhej të ikej, ndoshta armiku e zinte atë vend e duhej lanë edhe tjetër pikë. Kështu, ata kishin shkuar në Presedel. I kanë kallëzuar Fadilit që na kanë zënë

e na kanë lëshuar shokët e Hysenit, po armët na i kanë ndaluar. Unë s'po dija. Mbas nja tri dite unë isha në komunë, pak para dreke, më kishte thirrur Rifat Pira, që i kish zënë nuse vëllait, se i pat vdekur gruaja e vëllait. Unë duhej të shkoja, se ishin keq me Tërpezën këta Shabantë. Një polic më thotë: Hasan Alia po do të hyjë brenda me do djem. Kur hyri Hasani u përshëndetëm. Trim ish boll. Po unë në mal rrallë e kam takuar. Ai ka vdekur. E kam dashur shumë. E ka pasur një behane. Rahmet për femra nuk ka pasur. Ku shkonte, çka gjente, shkinë a magjupe, e zinte. Këtë punë e ka pasur sëmundje, me nder me thanë. Ai për komb ka qenë. Rrinte edhe me komunistë. Për të shpëtuar jetë! Ky Hasani ma qiti një letër. Kishin kaluar tre vjet. U mësova edhe të lexoja nga pak.

Thotë: *I dashtuni patriot! Asht interesi i kombit me u takue!* Nuk përmend që na i ke ndaluar pushkët, as kurrëgjë. *Ju fale-minderit që na shpëtua!* Por sot duhet me u takue.

Aty ishin dy mijë italianë, policë e vullnetarë.

Hasani ma solli letrën aty. S'guxon t'i besosh as sekretarit, as policit, askujt. Në ato rrethana njeriu shkon me kokë. I shkon kryet dikujt!

I thashë, Hasan, mos u ngut! Shkojmë bashkë te Rifat Pira. Hamë drekë aty. Se po shkuam në Presedel, s'mund të kthehemi shpejt. Një natë duhet të rrimë atje. Të nesërmen vijmë në komunë. Hëngrëm bukë e shkuam atje. E bëmë për hair. E pimë nga një kafe. Kaloi dita. U thashë: Të na falni, se i kam do punë. Gjithkrah kërcitke. Bëheshin do vrasje. U thashë

kam punë me do akte në komunë për t'i përcjell. Sekretar i Pozharanit ish ai Bejta, por as atij s'i besoja. Veç me Hasanin kam punë diçka në Hogosht. Ishte verë. Kallamboqtë ishin rritur, ishin mbushur. Kur shkojmë në Tërpezë hymë në oborr. Nana e njihte edhe përpara Hasanin. Ai kish qenë tek unë. Na luti për bukë nana, por i thashë kemi hëngër. Po ku po shkoni? – po thotë nana. Pse nuk keni marrë policë me vete? Po shkoni vetëm dy veta!

Hajt, bre nanë, i thashë, e kam me veti Hasan Alinë, e mos u bëj merak! Ngadalë, përpjetë. Ishim me xhemperë. Shkuam në Sllakoc të Muhaxherëve, e morëm Ukë Doberjancën, ishte trim, po plak. Ndenjëm pak, nga një kafe dhe i thashë: Çohu mixha Ukë! Kemi punë në Sllakoc të Jerlive. Shkuam veç ne tre: Hasani, Uka dhe unë.

Ishim skaj livadhit pa kositur. Mali ishte andej, krejt terr. Ata janë në majë të Presedelit. I thashë: Hasan, ti shko e thuaj Fadilit le ta marrë veç Kurtesh Agushin. E dija se ai ishte me ta. Xheladini (Kurbalia) shkoi në hyqymet. I thashë: Hasan, qysh të mundesh, merr vesh sa serbë kanë me vete aty!

Sa vjeç ka qenë Hasani atëherë?

– Valla ka qenë më i ri se unë nja një vit a dy vjet.

Hasani po me thotë mua, unë rri me ta shumë herë, por nuk ka serbë me ta.

More, po i them, ata e flasin shqipen, shqip flasin. Serbë ka me ta. Po më shtyn mua të pyes, një shoq e kam me ta dhe ai më kallëzon. Kur shkon, takohet me ta. U tregon se kryetari ka dalë me mua. Është me kryeplakun e

katundit. Hasani merr vesh se gjashtë serbë janë me ta. Tash u siguria. Fadili e merr Kurtesh Agushin edhe një djalë prej Gjakove, Hysen e kish pasur emrin. Paj, kish qenë 20 a 21 vjeç. Fadili i ka thënë shko këqyr mos e ka ndërruar vendin, për mua. Mua po më thotë se janë gjashtë serbë me ta. U avit e më tha: këtu janë në mal. Mali ish i shpeshtë e i madh, ishte mbyllur krejt.

Kur dolën në lëndinë, Fadilin e Kurteshin i njihja. Ai tha, ky tjetri është një shok, e ka emrin Hysen. Thashë e gëzoftë që e paska emrin si unë.


Unë u ula këtu e ai aty. Fadili, Sahiti, mixha Ukë, Kurteshi afër Fadilit. Ai djali i ri andej, Hasani këndeje. Ia nisi Fadili po më falënderon që i shpëtua prej luftës, po më ngrit në qiell. E bëre detyrën, je shqiptari më i mirë. Shpëtua. Nuk shkon pak ditë e Italia po bie! Po thotë, ti përgatitu, se ke bërë punë patriotike. Ti do të jesh komandant i brigadës në këto anë. Do të formohet një brigadë.

I thashë: Fadil, a mbarove? Unë të kam thënë para tre vjetëve se edhe po të të gjej fjetur, nuk të vras! Të kam thënë që je gabim, se këta, kur të mbarojë lufta, e di çka bëjnë. Unë e vras veten e nuk punoj me komunistë, me serbë nuk punoj. Le të jenë edhe nacionalistë, unë nuk punoj me ta.

Po thotë: Ngadalë, mos u ngut! Boll patriot je, por po ngutesh. Politika e do ngadalë.

I thashë s'ka politikë! Folëm shumë, por kot. Ishte verë, dita e gjatë. Kishte kohë edhe dy orë deri në terr. Prej aty shihej Sllakoci i Muhaxherëve. Na jemi në livadh. Nuk tutemi.

A po e sheh katundin? – i thashë



Fadilit. Tash çohemi, shkojmë e lypim bukë aty. I thashë kjo le të jetë nata e fundit që të takoj ty! E çojuni bukë shokëve. Ti rri këtu me Kurteshin. Kthehet Hasani. Ne po hamë darkë te mixha Ukë. E shtunë ka qenë ajo ditë. Nesër është e diel. Do të t'i dorëzohet katër armë që t'i kanë marrë shokët, se unë nuk jam plaçkaxhi. Nuk t'i plaçkiti ty armët. Je shqiptar, bre. Shyptari shyptarit t'ia marrë armën, unë nuk pranoj. S'po flet hiç Fadili, veç çehrja po i luan. Pak pa u çuar, Kurteshit, ish si zaif, i ka rënë plisi, kur po ia shoh përfund flamurin, në plis brenda. I thashë: Kurtesh, çka asht ai ylli brenda? Zotni, ai është shenjë e pesë kontinenteve. I thashë: Ai është shenjë e zezë për ta zhdukur popullin shqiptar edhe botën. Por, populli shqiptar të qitet fare krejt. Fadili tha: Allah-allah, nuk është punë të ta mbush mendjen. Ke marrë turr të gabuar, më tha Fadili. Kur u çuam i thashë: Në sabah t'i dorëzohet katër armë. Këqyre sahatin, të hënën, në orën 12.00, kam me ta qitë fuqinë shyptare, e nuk do të të lëmë vend në këto male. Në qoftë që e sheh një italian në forcën time, mos më thuaj shqiptar. E sheh! Më vjen turp të të them, hajde t'i ndjekim shqiptarët. Unë kisha vullnetarë boll. Ishte hallakamë. Iu prish çehrja. Ai e kishte pasur mendjen të më vriste, po s'ka guxuar.

Hasan Alia, a ishte me ju aty?

– Po. Fadili më tha, as nuk vij të ha bukë, as nuk dua bukë, as nuk i dua armët. Më tha, e paç në qafë Kosovën e Metohijen, se unë do ta liroj. I thashë: Valla ia ke vënë futën e zezë, mbaje mend, Metohijes e Kosovës e krejt popullit shqiptar. Udha mbarë! Mbarë paç! Armët nuk i dua, asgjë nuk dua. Si shkon, shih çka ka bërë, i poshtri. Këtë s'e kisha menduar kurrë. Menjëherë t'u pi ujë.

Kofën e tradhtisë! (thotë intervistuesi)

Këqyre çka ka bërë. E pati me vete atë Hyesnin. Ata menjëherë e paskan lënë Kosovën. Po dalin punët në mejdan. Një djalë, që ka qenë aty, e kam zatet në Itali. Gjallë ka qenë deri vonë. Ai kish pas ikur. Mbas nuk mundën të më mashtronin, i ka marrë shokët e kanë dalë në malet e Gjakovës. Edhe Italia ra. Ajo ra, por po e merr në dorë komandën, po dihet kush. E kanë caktuar komandant një Beqir Malokun. Ai ish 70 vjeç, gjakovar. Ai ka qenë spiun qysh në Luftën Ballkanike, me serbë ka punuar, kolonel kish qenë. Kishte forcë prej 600 vetash. Shqiptarët i kanë bërë tubë. Edhe ai Beqir Maloku e paska pasur një nip 17-18 vjeç duke punuar me komunistë. E merr atë e i thotë: Beqirin e ke mixhë, bre. I thotë atij, edhe këtij Hyesnit, që ish me Fadilin,

shkoni te Hysen Tërpeza, se ai na njeh, na ka dhënë bukë tre vjet. Ju shkoni, kallëzoni që ne jemi lidhur me ta. Edhe Fadili është takuar me të. Ti thuaji, na kemi gabuar, jemi të rinj. Atëherë ai i ka shtrënguar 160 italianë me autobusë. Shteti e zë lepurin me qerre. Ata e kishin pasur njëfarë shenje, njëfarë ushtrie pak tjetër. Ai i gjallë nuk dorëzohet dhe e kris pushkën çdo minutë, u ka thënë për mua. Këta i ndalën në Pozharan qerret rreth xhadesë, kishe po shkojmë në Gjilan. Ushtri kanë qenë, e kanë hyrë në komandën italiane. I kishin pas çuar dy policë në komunë. Kur kanë shkuar policia, unë nuk isha ende në komunë. Mua, që besoj Zotin, më hyri një frikë pa më thënë kush kurrë. Mora vesh se po i hallakatin këta njerëzit që e shpëtuan Fadilin atje. E kisha një polic me vete. Më shkoi mendja mos po vijnë natën e më rrethojnë me italianë.

Shkoj e i them nanës, unë po shkoj mysafir në Zhiti diku. Jam te Hajriz Hajolla.

Këta i paskan përgatitur 160 ushtarë e i kanë lënë kamionët para ushtrisë së rregullt italiane. U kanë thënë, sekretari nuk është këtu, për mua. Kanë shkuar, e kanë rrethuar shtëpinë. Nana është çuar herët. E kemi pasur oborrin të madh. Do gjermanë me këta. Thonë, mos merr në qafë askënd, se të ka rrethuar hyqymeti. Nana serbez, nuk ka ditur gjë. U thotë, çka u bë kjo punë, more bir? Djali jem nuk është kaçak, ai është në komunë. Nana shkon te dhoma ku ka qenë vëllai fjetur e i thotë: Çohu e shko në Zhiti te Hajrizi, e thuaji djalit që po të lypin në komunë. Hala nuk kishte lindur dielli, veç sa kishte nisur të zdritej. Djali është çuar në këmishë e done. Ishte verë. Më kujtohet se Hajrizi pati një dorë nuseje a diçka. Hajrizi ka qenë njëfarë hajvani, veç lëvdohej. Çohu, më tha, se je bërë si fëmija. E dija punën. Po i them: Hajriz, mua po më kërkoni gjermanët. Ai po më thotë kurrë nuk ke qenë më i fortë. Mersel Bajra, Zenel Lipovica kanë shkuar tek unë në shtëpi. Ku është? Në Zhiti, te Hajrizi. Ata pak përpara erdhën. Edhe ata aty. Hasan Alia, edhe ai erdhi aty. Ata na bënë muhabet. Na zunë. Çka po tutesh? Miqtë e jaranët më të mirë i ke këtu. Qe, malin e kemi afër. Kur ka ardhur Ademi te dera, ka pyetur a asht këtu Hyseni? Po. Thoni po e lypin gjermanët. Erdhi Ademi, unë u bëra merak se çka ka dhe e veta. Vallahi nuk e di, tha ai, veç gjermanët të kishin lypur. Dola jashtë me Ademin, e ai po më thotë, oborri ka mbetur plot. Aty boll lavde ka pasur, po një nuk u çua të vinte me mua. Trimat më të mëdhenj ishin: Zenel Lipovica, Mersel Bajra. Mos e çohajzin në front, se po ik me alltinë në shokë. I madh sa të duash, kur po e



shohin shokët. Muharrem Fejzën e kam njohur mirë. Merseli më tha ti më i fortë nuk ke qenë kurrë. Malin e kemi në derë. Po, i thashë, malin në derë, po unë i kam njerëzit në shtëpi. Nejsë, teposhtë, ramë në Zhiti. Po shohim, dolën një grua e një burrë. Një Selmani ka qenë i mëhallës sonë, e ka pasur gruan prej Malisheve. Po e përcjell gruan, po del me të. E ndali roja gjermane. Dola përpara nga lluga, e pyeta çka ka? Policia ka kërkuar andej-kënde, po një njeri kur është i mirë, ai shpëton. Mua mileti më ka dashur. Po me pushkë në dorë na ka shkuar jeta. Nejsë, ndenja unë fshehtas nja shtatë a tetë ditë. Kur morëm vesh, më ka dalë pushimi mua. Xhafer Deva më ka pushuar. Janë çuar tërë Tërpeza e Pozharani, nja 30 veta, e kanë shkuar në Prishtinë. I kanë thënë se gazeta po shkruan që ai hala është në punë. Ka qenë një prefekt që më donte. Kanë shkuar brenda, i kanë thanë: Ai u thotë se prej kufirit të Shqipërisë e kënde unë jam president. Hysen Terpeza nuk pushohet nga detyra. Unë po dua të shkoj në Tiranë njëherë. Shkova të nënprefekti e i tregova. Unë po çuditem, tha ai. Kam thënë, kur të pushojnë ty, do t'i pushojnë krejt kryetarët e Kosovës. Ty nuk të lëshoj. Ti je duke luftuar. Dua të të çoj kryetar në komunë të Hogoshtit. I thashë, nuk shkoj. O në Pozharan o tjetërkund nuk shkoj. Ai tha, ngadalë, se unë i kam lënë shumë më shumë kilometra e nga Shqipëria kam ardhur këtu. I

thashë se ti je me profesion i kësaj pune. Unë nuk e kam profesionin të jem në detyrë. Unë jam katundar, me armë në dorë. Dola, shkova në komunë e bëra letrën të shkoja në Tiranë. E çova një njeri tek Isak Sllatina, te Musliajt. Ai thotë unë kam lajmëruar Hysen Begun në Tiranë për ty dhe ai do të bëjë diçka. Shko njëherë në Prishtinë e ruaju mos të zënë me armë. Po të zunë me armë, të pushkatojnë menjëherë. E lashë armën diku e veç alltinë në shokë e kam pasur. E gjeta Zijah Kosovën, e njihja. Ai më tha po të takoj me komandantin gjerman. Që ta takoja pranova, por jo në zyrë. Mendoja diku në ndonjë shtëpi private. Unë i gjallë nuk dorëzohem, i thashë. Alltinë në shokë e të dorëzohem, jo! E kanë gjetur një shtëpi te një beg. Njeri të gjallë nuk kam parë aty. Kur kam shkuar, erdhën e më thanë, Zijaja tha: Veç unë vij me ty. Koloneli gjerman do të të pyesë diçka. Koloneli kish qenë aty. Një përkthyes ishte aty. I ditke të gjitha gjuhët. Ma vonë ka vdekur në Itali. Shqiptar ishte. Ai po më thotë të më tregosh çka ke me gjermanët? I thashë kurrë s'kam. Unë e di veç Zotin edhe gjermanët. Kishin marrë pak informata nga shërbimet e italianëve. Unë i thashë se ata nuk e kanë thënë të vërtetën për ato kontaktet me komunistët. Ne e njohim vetëm gjermanin. Unë e kam kuptuar punën për ty. Ti je një njeri i mirë. Ma jep besën që ti nuk do të jesh kundër gjermanëve. Ta jap një automatik, më tha. Ta jap

një letër që, kur të kesh nevojë, të duhet. Ushtrinë gjermane e ke në dispozicion. Edhe të shkosh në komunë ku ke qenë, aty. I thashë automatikun e kam timin. Nuk dua forcë. Forcën e kam timen. Në komunë nuk shkoj. Iu prish çehrja. Flisnin ata me Hitlerin, oficerët. Ti je i lirë në emër të Gjermanisë. Shko, më tha. S'do të të ngucë askush. Xhaferi e ka pasur një togë. Veç e mbyste njeriun ashtu pa kurrë. Unë e kam takuar shumë herë, por u prisha me të politikisht. Kur ishim në Lidhje të Prizrenit, u prish krejt, na përzuri përjash-ta. U bë me hile krejt. Shkoi Rexhep Krasniqi, ish-kryetar i Komitetit Shqiptar "Shqipnia e lirë" në Nju-Jork. Kosovën nuk e kanë pranuar në komitet. Shkoi atje Rexhepi, kur erdhi, e kishin lënë kryetar Xhafer Devën. Po shqiptarët e Shqipnisë së vjetër nuk emërohen anëtarë të Lidhjes së Prizrenit. Qysh mund ta pranojnë dikë anëtar nderi e jo një njeri tonin. Anëtar nderi mund të pranohet edhe një i huaj e jo yni.

A u kthyet më në komunë?

– Po, u ktheva. Ruheshim nga pak, se s'kish kurrë. Kam fjetur me armë në dorë.

A reagoi kush më?

– Jo, u tutën! Më askush nuk tha asgjë! Shqiptarët, shumica, më donin.

Qe marrë vesh, aty puna qe nga italianët. Kanë shkuar e kanë marrë Ukë Dobërjacin, që ka thënë se edhe ai ka qenë aty, kur kam bërë llaf me Fadilin. U rregullua puna ime dhe u pa që Fadili i ka bërë këto. Thoshin se edhe nga havaja po të vijë dekreti, këtij nuk ka kush çka i bën.

Po, jemi të ligj! Erdhën njëherë bash ata që ma bënë kurthin; Zhitia, Ballanca, Tërpeza, për inat i bënë këto punë. Ata kishin thënë se nuk mund të hyjë ai më në komunë. Por, Kamer Maloku u kishte kallëzuar një përrallë. Kish qenë një lis i madh i rrezuar. Ishin munduar 40 veta ta çonin e nuk mundnin. Njëzet e trusnin teposhtë e njëzet përpjetë, për ata nuk mundnin ta çonin. Thonë Hysenin nuk mund ta heqin, se ka njerëz që e mbajnë. Ka pasur njerëz që më kanë dashur. Një i Prizrenit, kur më kanë liru gjermanët, ka qerasur krejt njerëzit që ishin në një kafe në Ferizaj. Të gjithë e dinin që unë me serbë nuk punoj. Qe çrregulluar krejt gjendja. Komunisti gati ishte ta merrte, por gjendja ishte hala e keqe. Gjermani ra!

(Intervistë e realizuar nga Sami Dërmaku, botuar në librin "Dëshmi kohe" nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Vijon nesër) /Epoka e re/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Laura Fazliu, e argjendtë në Jerusalem

PRISHTINË, 21 DHJETOR (ER) - Sporti i Kosovës ka marrë edhe një lajm të mirë të mërkurën, pasi xhudoja i ka sjellë edhe medaljen e dytë nga Mastersi i xhudos që po mbahet në Jerusalem. Të martën medaljen e artë e fitoi Distria Krasniqi, kurse të mërkurën me të argjendtën është stolitur Laura Fazliu, e cila pati paraqitje të mira, por në finale nuk kishte shumë fat për ta rrëmbyer medaljen e artë. 22-vjeçara ishte bartëse në kategorinë deri 63 kilogramë, kurse ka zhvilluar katër fitore. Fazliu në finale pësoi humbje nga xhudistja e Japonisë, Miku Takaichi. Laura fillimisht e mposhti Manon Deketer, pastaj fitoi edhe ndaj Andrea Leshki. Në luftën e tretë e gjunjëzoi Angelika Szymanska, derisa më pas fituese doli edhe ndaj Gili Sharir. Pasi fitoi medaljen e argjendtë, Laura ka fituar 1 200 pikë në ranglistën botërore dhe ka bërë hap të madh drejt kualifikimit në Lojërat Olimpike "Parisi 2024". Të martën ka garuar edhe Nora Gjakova që e zuri vetëm vendin e pestë, kurse sot (e enjte) garon Lorian Kuka në kategorinë deri 78 kilogramë.



Edin Kërveshi emërohet trajner i KB Ponte Prizreni

PRIZREN, 21 DHJETOR - Edin Kërveshi do jetë në krye të shtabit teknik të KB Ponte Prizreni. Ai së bashku me ndihmëstrajnerin, Rigon Hasi, do ta udhëheqin skuadrën prizrenase. "Nga sot zyrtarisht Edin Kërveshi do të jetë në krye të shtabit teknik të KB Ponte Prizreni, ku së bashku me ndihmëstrajnerin Rigon Hasi do ta udhëheqin skuadrën. Trajneri Kërveshi edhe në të kaluarën ishte për katër sezone në skuadrën e Ponte Prizrenit. Një falënderim i veçantë shkon për udhëheqësin e KB Bashkimi të cilët na mundësuan këtë kalim", thuhet në njoftimin e KB Ponte Prizreni.



Sonte zhvillohen dy ndeshje në Superligë



Prishtinë, 21 dhjetor - Të enjten do të zhvillohen dy ndeshje nga xhironja e 15-të në Prince Caffè Superligën e Kosovës në basketboll. Ndeshje shumë e rëndësishme do të zhvillohet ndërmjet Bashkimit dhe Vëllaznimit. Prizrenasit kanë katër fitore e dhjetë humbje, kurse kuqezinjët kanë gjashtë fitore e tetë humbje, andaj pritet një ndeshje shumë interesante në

Prizren. Kjo ndeshje do të zhvillohet në Therandë, për shkak se palestra në Prizren është në rinovim. Po të enjten do të përballen Trepça me Ponte Prizrenin. Mitrovicasit kanë shtatë fitore e shtatë humbje, kurse prizrenasit gjashtë fitore e shtatë humbje, prandaj shihet një duel shumë interesant në Mitrovicë. Takimi ndërmjet Rahovecit dhe Golden Eagle Yllit është shtyrë për

më vonë. Ndeshja ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Pejës do të zhvillohet më 11 janar 2023 për shkak se prishtinasit garojnë në ENBL Ligë.

SUPERLIGA - Java 15

Të enjten takohen:
19:00 Bashkimi - Vëllaznimi
19:00 Trepça - Ponte Prizreni

Rashica: Shqiptarët dhe turqit janë të ngjashëm

STAMBOLL, 21 DHJETOR - Lojtari kosovar në Galatasaray, Milot Rashica, ka folur për të kaluarën e tij në Kosovë si dhe për marrëdhëniet në mes të Kosovës e Shqipërisë, me Turqinë. Rashica ka thënë se marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Turqisë janë të ngushta dhe se njerëzit janë të ngjashëm sa i përket kulturës dhe ushqimit. "Në Turqi jetojnë shumë persona me origjinë kosovare dhe shqiptare. Këtu ka edhe lojtarë kosovarë që luajnë në klube të tjera. Përveç kësaj, Turqia është një nga vendet e para që ka njohur Kosovën. Ne mbajmë një marrëdhënie të ngushtë. Ne jemi njerëz të ngjashëm; kulturat tona dhe madje edhe ajo që pamë janë shumë të ngjashme", ka thënë Rashica në një intervistë me klubin.

Rashica tregoi edhe për historikun e tij në fillet e karrierës. "Mendoj se kam qenë rreth gjashtë apo shtatë vjeç kur daja më ka çuar në një shkollë futbolli në Kosovë. Në Kosovë ka shumë shkolla futbolli dhe këto shkolla futbolli zakonisht themelohen nga ish-futbollistë. Shumë futbollistë vijnë nga Kosova, kështu që pas karrierës së tyre si futbollistë ata krijuan një shkollë futbolli për t'oi promovuar të rinjtë. Kam shkuar në dy-tri shkolla të ndryshme futbolli në Kosovë. Më vonë shkova në Prishtinë, kryeqytetin e Kosovës. Kam luajtur atje për disa vjet para se të kthehesha në qytetin tim të lindjes dhe të luaja për FC Vushtrria", është shprehur 26-vjeçari. Ylli kosovar foli edhe për transferimin në klubin turk, duke



thënë se ishte e veçantë për të kur u prezantua me yjet si Mata e Icardi. "E dija që Galatasaray ishte përpjekur të më merrte që nga fillimi i afatit kalimtar, por gjatë asaj kohe ne nuk kishim qenë në gjendje të arrijmë një marrëveshje me Norwich Cityn për një tarifë

transferimi. Megjithatë, një marrëveshje u arrit më vonë, dy ditë para përfundimit të afatit kalimtar. Isha shumë i kënaqur që Galatasaray u përpoq të më gjente. Vazhdova të flisja me menaxherin tim, sepse doja shumë të bashkohesha me

Galatasarayn, një klub që është me të vërtetë popullore në të gjithë Evropën. Më në fund transferimi u përfundua dhe jam i lumtur që jam këtu në Stamboll. Ishte e veçantë për mua të prezantohesha me yje si Mata dhe Icardi dhe lojtarë të tjerë në të njëjtën ditë. Ishte një ditë e gjatë dhe emocionuese. Kontrolli mjekësor, më pas foto dhe videoincizime në fanellën verdhekuqe. Ishte me të vërtetë gjithçka shumë argëtuese dhe një përvojë vërtet e bukur. Ishte gjithashtu shumë profesionale që e gjithë kjo si dhe puna e letrës u krye në kohën e duhur në të njëjtën ditë. Për të qenë i sigurt, isha shumë i kënaqur që kushtet e përgjithshme funksionuan kaq mirë".

Verstappeni: Nuk e kuptoj se si ndryshoi gjithçka, në fillim të sezonit ishim të mbaruar

HASSELT, 21 DHJETOR - Max Verstappeni festoi titullin e dytë kampion për pilotë në Formula 1, një arritje që në fillim të sezonit dukej e paimagjinueshme. Piloti holandez kujton deklaratat e fillimsezonit, ku shprehej se do të duheshin 20 vjet për ta arritur

Ferrarin, që dominonte në garat e para, ndërsa Red Bulli tërhoq dhe nuk merrte pikë. "Ndershmërisht, fillimi i sezonit ishte një dilemë e madhe për ne, pasi nuk dinim se ku po shkonim. Ne na dukej sikur gjërat ishin në rregull, por asnjëherë nuk di se çfarë bëjnë të

tjerët. Kur erdhi gara e parë sezonale në Bahrein kishim shumë pikëpyetje dhe nuk e kuptonim se çfarë kishim bërë gabim", ka thënë Verstappeni. "Nuk po tregonim potencialin real të makinës sonë. Modifikimet që bëmë përgjatë sezonit ndryshuan gjithçka në

favorin tonë, sidomos në humbjen e peshës së makinës. Nuk duhet të harrojmë që edhe rivalët tanë bënë disa gabime, por sinqerisht nuk mendoja se do të festonim në fund të sezonit kur pamë nisjen katastrofike që bëmë në mars-prill", ka shtuar Verstappeni.



Shkëndija e para për klubet shqiptare, Drita lidere për Kosovë



GJILAN, 21 DHJETOR - UEFA ka publikuar ranglistën e klubeve që marrin pjesë në Kupat e Evropës duke i renditur sipas koeficientit që llogaritet falë paraqitjeve në pesë sezonet e fundit. Drita është klubi me renditjen më të lartë nga liga e Kosovës, duke u renditur në vendin e 199, ndjekur nga Prishtina, Ballkani, Llapi, Gjilani dhe Feronikeli. Sa i përket ligës së Shqipërisë, Laçi është klubi që

pozicionohet më së miri, duke zënë vendin e 174-t, gjersa më pas vijnë Partizani, Teuta, Kukësi, Tirana, Vllaznia, Luftëtari. Nga liga e Maqedonisë së Veriut, Shkëndija mban vendin e 151-të në ranglistë. Me koeficientin 9 500 Shkëndija jo vetëm që është ekipi më mirë i ranguar nga Maqedonia e Veriut, por udhëheq listën e klubeve edhe nga Shqipëria e Kosova.

Kosovë	
199) Drita	
304) Prishtina	
334) Ballkani	
370) Llapi	
371) Gjilani	
372) Feronikeli	
Shqipëri	
174) Laçi	
254) Partizani	
280) Teuta	
282) Kukësi	
298) Tirana	
338) Vllaznia	
411) Luftëtari	
Maqedoni e Veriut	
151) Shkëndija	
185) Shkupi	
356) Makedonija Gj.P.	
361) Sileksi	
382) Akademia Pandev	
409) Renova	
417) Struga	
418) Vardari	
418) Rabotniçki	

Denveri merr kreun në Perëndim, kampionët turpërohen nga New York

DENVER, 21 DHJETOR - Skuadra e Denverit ngjitet në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 105-91 ndaj rivalëve të Memphisit, që zbresin në vendin e dytë. Nikola Jokiq, protagonist për Denverin me një "triple double", duke realizuar 13 pikë, 13 rebounde e 13 asistime. Gjithsesi, të gjithë titullarët e Denverit realizuan mbi 12 pikë, duke i bërë të pavlefshme 35 pikë e 10 asistime të Ja Morant për miqtë. Tjetër humbje e thellë për kampionët e Golden States, që u mundën me rezultat 132-94 nga New York, që korri fitoren e tetë radhazi. Poole me 26 pikë nuk mund ta evitojë humbjen për



Warriorsin, ndërsa për njujorkezët u dalluan Quickley me 22 pikë e Brunsoni me 21 pikë. Jashtë fushës fiton edhe Chicago, që mundi me rezultat 113-103 Miamin, me Vuçevićin protagonist, duke realizuar 29 pikë e 12 rebounde. Humbet skuadra e Phoenixit, që u mund me rezultat

113-110 në fushën e tij nga Washingtoni, një rezultat surprizë. Kuzma me 29 pikë e Beali me 27 bënë dallimin për miqtë, ndërsa 30 pikët e Aytonit mbetën për statistikë. Utah Jazz mposhti me rezultat 126-111 Detroitin, ndeshje ku shkëlqeu sërish Markkanen, autor i 38 pikëve për miqtë.

REZULTATET

Detroit - Utah Jazz	111-126
Miami - Chicago	103-113
New York - Golden State	132-94
Phoenix - Washington	110-113
Denver - Memphis	105-91

Van Gaali i vetofrohet Portugalisë

Portugalia është pa trajner, pasi Fernando Santos u largua nga përfaqësuesja portugeze menjëherë pas zhgënjimit në Botëror, ku

Maroku i shkaktoi një surprizë të hidhur. Jose Mourinho mbetet dëshira më e madhe e stafit drejtues, por njëkohësisht

edhe opsioni më i vështirë, në një kohë kur "speciali" është nën kontratë me Romën deri më 2024. Së fundmi është Luis Van Gaal

ai që shpreh pëlqimin për një aventurë të tillë: "Jam sërish në pension, por do të dëgjoja me kënaqësi këtë propozim, nëse vjen. Më

shumë se kaq nuk mund të them". Van Gaal në Botërorin e sapopërfunduar ishte trajner i Kombëtares së Holandës.

SHKURT

Cana: Në vitin 2002 më ftoi Franca

Ish-kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Lorik Cana, ka konfirmuar se në vitin 2002 kishte marrë ftesë nga Franca për të luajtur për Shpresat. "Po, kisha thirrje nga Shpresa e Francës në vitin 2002. Ishin të gatshëm të më bënin nënshpëtimin dhe pasaportën për të luajtur për Francën. Po flasim për verën e 2002-shit. Atëherë nuk i kam dhënë një rëndësi shumë të madhe pasi kisha gjithmonë në kokën time se nëse do të bëhesha një futbollist profesionist, do të zgjidhja gjithmonë të luaja për Shqipërinë", ka thënë Cana.

Reali e ka seriozisht interesimin për Gvardiolin

Skuadra e Real Madridit është seriozisht e interesuar për mbrojtësin kroat që është pjesë e Leipzigut, Josko Gvardiol. Paraqitjet e mira në Kupën e Botës kanë bërë që shumë klube të shprehin interesim për Gvardiolin. "Los Blancos" planifikon që në muajin tjetër të bëjë ofertë për futbollistin, i cili kohë më parë ka treguar se dëshira e tij është që të luajë për klubin madrilen.

Ronaldo për momentin ka vetëm një ofertë

Karriera e Cristiano Ronaldos mund të marrë një kthesë të fortë dhe të papritur. Asi portugez është një lojtar i lirë pasi prishi kontratën me Manchester Unitedin, por kjo nuk mjafton për të gjetur një skuadër të re, të paktën jo në Evropë, aty ku ai dëshiron. Mbi tavolinën e yllit portugez ekziston vetëm një ofertë, ajo e Al-Nassrit, por edhe këtu gjërat nuk janë ashtu siç flitej. Sipas "AS", paga është shumë larg asaj që është lakuar në medie. Që nga 22 nëntori, ditë kur Manchester Unitedi njoftoi divorcin me Ronaldon. Sulmuesi portugez mori një propozim zyrtar nga Al Nassr për një kontratë deri më 2025. Në Evropë janë përfolur shumë për Atletico Madridin dhe Chelsean, por deri më tani nuk ka pasur asnjë kontakt konkret mes palëve për të gjetur një marrëveshje.

Isco largohet nga Sevilla

Sevilla ka zyrtarizuar këtë të mërkurë divorcin me ish-mesfushorin e Realit të Madridit, Isco. Vetëm pas katër muajsh e gjysmë me ekipin andaluz, Francisco Alarcon Suarez ka prishur kontratën në mënyrë konsensuale dhe tashmë është i lirë të firmosë me çdo skuadër. Isco është aktivizuar në 12 ndeshje të La Ligas deri në këtë pikë të sezonit, por nuk ka mundur të shënojë qoftë një gol. Me largimin e Lopeteguit, mesfushori ka dalë i tepërt, kështu që ka kërkuar prishjen e kontratës.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Media Box" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811991331 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Media Box" D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811991331 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Media Box" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811991331 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

www.facebook.com/gjeipuneshpejte


RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Adil Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik-Prishtinë UP.

- Marigona Prenaj nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën për kryrjen e arsimit profesional të SH.M.të mjeksisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- "Admaria" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811870204.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales